



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 04.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.04.2025 të parashtruar nga **OE Noi Construction shpk, Lipjan, për aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan me nr të prokurimit: 613-25-851-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim OE Noi Construction shpk, Lipjan, për aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan me nr të prokurimit: 613-25-851-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK i publikuar në platformën e prokurimit i datës: 28.03.2025, i propozuar për kontratë OE Grup i Operatorëve Ekonomik BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli Ferizaj

1. **Mbetet në fuqi Vendimi i AK i publikuar në Platformën e Prokurimit** i datës: 28.03.2025
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Sqarim lidhur me qasjen tuaj:

Autoritet Kontraktues duke ju referuar nenit 68 dhe 69, lidhur me nrnin 7, te Ligjit per Prokurim Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), nenit 7 te Rregullores per Prokurim Publik 001/2022, versioni i konsoliduar 11.11.2024, interpretimit te dt:24.10.2023, pytja e 31 te publikuar nga KRPP, i ka ofruar qasjen ne versionin e pastruar. Pasi qe OE ka plotësuar kushtet, sipas LPP-se, legjislacion baze dhe i veçant per Prokurim Publik.

Sic vijon:

Autoritet Kontraktues i ka lejuar qasjen sipas LPP-se, në Ofertën OE "BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K." me rastin e ofertimit ka plotësuar aneksin 3 të DT përmes të cilit ka kërkuar nga AK – KUVENDI KOMUNAL LIPJAN, që informatat dhe dëshmitë sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji të klasifikohen dhe mbesin si sekret afarist për të gjitha palët duke përjashtuar palët e përcaktuara të nenit 7.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Sipas kërkesës në fjalë OE "BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K." ka kërkuar mbrojtjen e konfidencialitetit komercial me arsyetimin se informacionet apo dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me dokumente publike, dhe se vënja e tyre në dispozicion për OE konkurrent apo palët tjera, si dhe zbulimi i qëllimshëm apo nga pakujdesia do të rezultonte me dëmtim material dhe jo material të interesave komerciale legjitime të afarizmit të tij.

AK konsideron se në këtë çështje ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e dispozitave ligjore për promovimin e transparencës sipas nenit 10 dhe 11 të LPP- së lidhur me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si dhe në përputhje me rregullat e përgjithshme administrative sipas nenit 5 dhe 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Interpretimit te dt:24.10.2023, pytja e 31 te publikuar nga KRPP, i ka ofruar qasjen ne versionin e pastruar. Në mes të tjerash citoj

"7.3 Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuar nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente"

Përgjigje për pretendimin tuaj te Parë:

Kerkese e AK pika a) ka qene Min Nje inxhinier i ndertimtarise sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit,
Gjate kontrollimit te dokumentacionit tuaj ju keni vendosur dokumentacion per inxhinierin tuaj por tek diploma e tij eshte verejtur qe Diploma eshte mbrojtur me date 9 Mars 2022 dhe kjo nuk eshte 5 vite pervoji pune pas Diplomimit siq eshte kerkuar nga AK

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Përgjigje për pretendimin tuaj te Dytë:

Tek Deshmia 2 eshte kerkuar: Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti.

E drejte e AK eshte te paraqes kerkesen per nje dokument te caktuar dhe ne kete rast secili punedhenes duhet te dij qe nje kontrate e punes element baze ka kohen e fillim/mbarimit, pagen dhe elemente tjera qe percakton ligji i punes e jo AK.

Tek dokumentacioni juaj eshte verejtur qe nuk i keni te gjitha kontratat e punes per stafin tuaj poahtu edhe te ato kontrata dhe parakontrata qe keni bashkangjitur jane te mangeta ne baze te ligjit te punes ju mungojne fillim/mbarimi dhe paga baze duke u bazuar ne ligjin Nr. 03/L-212, te nenit 10 dhe 11 po te ketij ligji. *Shtojce ligji i punes:*

Neni 10 Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

2.1. një periudhë të pacaktuar;

2.2. një periudhë të caktuar;dhe

2.3. për punë dhe detyra specifike.

3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.

4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindënjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

8. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës.

9. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me këtë ligj.

Neni 11
Përmbajtja e Kontratës së Punës

1. Kontrata e Punës përmban;

- 1.1. të dhënat për punëdhënësin (emërtimi, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit);
- 1.2. të dhënat për të punësuarin (emri, mbiemri, kualifikimi dhe vendbanimi);
- 1.3. emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës;
- 1.4. vendin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme,
- 1.5. orët dhe orarin e punës;
- 1.6. datën e fillimit të punës;
- 1.7. kohëzgjatjen e Kontratës së Punës;
- 1.8. lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër,
- 1.9. kohëzgjatjen e pushimeve;
- 1.10. përfundimin e marrëdhënies së Punës;
- 1.11. të dhëna të tjera për të cilat punëdhënësi dhe punëmarrësi i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës;
- 1.12. kontrata e Punës mund të përmbajë të drejta dhe detyra të tjera të parashikuara me këtë ligj;
- 1.13. të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;

2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për nevojat e punëdhënësve do të përgatisë mostra të kontratave të punës sipas standardeve minimale, për periudhë të pacaktuar, të caktuar dhe për punë specifike.

Ky pretendim i juaj është i Pa Bazuar

Përgjigje për pretendimin tuaj të Tretë:

Tek kërkesa 3, pika 1) është kërkuar Gersher për demolim betoni dhe prerese e cila montohet në eskavator min 5 T =(min 1 cope)

Sqarim: Në dokumentacionin tuaj kemi hasur në një dokument eskavator me zingjir tipi: 735 II LS dhe në këtë dëdë është edhe një faqe shtesë që ka një përberje shtesë të mjeteve të punës: Luge për pastrim të lumenjve, luge për germim 2 copa, qekan hidraulik, kran hidraulik dhe gersher për demolim, pasi që ju skeni pasur një dokument të veçantë për këtë kërkesë sipas pikes 1).

Poashtu në kemi shikuar lidhur me këtë eskavator se qfarë specifikimi mund të ketë dhe gjatë evidentimit duke u bazuar në të dhënat sipas dudit eskavator Furukawa tipi 735 II LS perket 18.9T, por në këtë dëdë janë edhe disa pajisje tjera shtesë që kanë peshe/tonazh të lartë siq janë:

1. Luge për pastrim të lumenjve 1 cope,
2. luge për germim 2 copa,
3. qekan hidraulik 1 cope,
4. kran hidraulik 1 cope dhe
5. gersher për demolim 1 cope,

Eskavatori në dëdë doganor me të gjitha këto pajisje janë 24,500 kg apo 24.5T, eskavatori në bazë të specifikimit sipas këtij tipi dhe nr është 18,900 kg apo 18.9 T, duke u bazuar në kg e mbetura janë dhe 5600 kg apo 5.6T, që nëse ndahen për secilën pajisje është 933 kg për secilën dhe ky DUD doganor nuk ka dokumente shtesë dhe si dëshmi e dorzuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën e AK-së dhe ju njoftojmë që AK nuk mund të marrë për bazë një dokument të tillë sepse është jashtë kërkesës së AK-së. Poashtu nuk është mundur të kërkohej sqarim shtesë sepse ju keni ofruar dëshmi e cila nuk është plotësuar.

Specifikimi për eskavatorin sipas të dhënave të këtij dudi doganor:

Technical specs - 735 LS-tronic Furukawa

Specification

Accessories

Datasheets

Specification

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. [Contact our team with any change suggestion.](#)

Weight	18.9 t	Transport length	9.5 m
Transport width	2.86 m	Transport height	2.95 m
Bucket capacity	0.8 m³	Track width	600 mm
Model series	LS	Engine manuf.	Furukawa
Engine type	F 659 T	Engine power	90 kW

More technical details, like: bucket capacity min., bucket capacity max., undercarriage, boom, max. reach horizontal, dredging depth, tear-out force, bucket width, dimension lxxh, displacement, revolutions at max torque, max. torque, no. of cylinders, cylinder bore x stroke, emission level are available in the full technical specs.

[Show less](#)

Basic model incl. ROPS cabin, traction drive, standard boom and standard bucket

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Përgjigje për pretendimin tuaj të katër:

Tek kërkesa 3, pika h) Eskavator max 1 T, ju keni dorzuar një dud doganor i cili nuk ka përmbajtje se kujna i perket ky dokument dhe nuk mund të mirret për bazë një dokument i tillë, pa të dhenat e pronarit dhe sikur ju nuk do të kishit vendosur asnjë dokument për këtë paisje në si AK do ju kerkonim sqarime shtese, por ju keni ofruar deshmi të cilat nuk përmbushin kërkesën dhe deshmite e kerkuara nga AK

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Ne rast se ju si OE do i perkisni keto dokumente qe nuk i keni vendosur ne oferten gjate aplikimit ju do ti ngarkoni ne kete kerkese per rishqyrtim por keto jane deshmi qe nuk mund te plotesohen dhe per te njejtat nuk mund te kerkohet sqarim shtese.

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,


Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Data: 04.04.2025

Bekim Shabani


Drejtor i Prokurimit